

**ROLI I KOMITETIT “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS” PËR  
ÇËSHTJEN SHQIPTARE NË MBRETËRINË SERBO-KROATO-  
SLLOVENE GJATË VITEVE 1918-1924**

**EKSPOZE E PUNIMIT MASTER**

**NGA**

**SARANDA BUJARI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**SHTATOR, 2022**

# ROLI I KOMITETIT “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS” PËR ÇËSH TJEN SHQIPTARE NË MBRETËRINË SERBO-KROATO- SLLOVENE GJATË VITEVE 1918-1924

**Mentori: Prof. Dr. Gazmend Rizaj**

Studimi *Roli i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për çështjen shqiptare në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene gjatë viteve 1918-1924*, ka të bëjë me trajtimin e një teme mjaft të rëndësishme për popullin shqiptar. Kur nga harta e Shqipërisë ishin ndarë disa treva të saj, Komiteti i Kosovës, ishte përgjigjia më e mirë ndaj kësaj padrejtësie. Komiteti i Kosovës, i formuar më 1 maj 1918 në ilegalitet në Shkodër nga patriotët dhe intelektualët e asaj kohe, do filloj punën legale më 7 nëntor 1918, si organizatë politike me karakter kombëtar, të formuar saktë dhe qartë, për të arritur objektivat kryesore, që kishin të bënin me: ndërkombëtarizimi e çështjes së Kosovës, rezistenca për çlirim dhe bashkimi me Shqipërinë.

Qëllimi i punimit është trajtimi në mënyrën më të detajuar i veprimtarisë së Komitetit të Kosovës, që nga fillimi i punës së tij e deri tek shpërbërja e tij. Për të realizuar një punim të tillë, kam përdorur metodat shkencore siç është metoda hulumtuese, analitike, krahasuese dhe metoda përshkruese. Punimi është i ndarë në katër kapituj, nënkapituj, përfshinë fotografi, në fund paraqiten burimet arkivore dhe literatura, dhe me anë të tyre jam munduar ta bëjë sa më të vlefshëm këtë punim shkencor.

Kapitulli i parë i emëruar “THEMELIMI DHE ORGANIZIMI I KOMITETI MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS 1918-1924” ka të bëjë me themelimin dhe organizimin e Komitetit “MKK”, për programet, shtrirjen e veprimtarisë së tij në degë të shumta si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, raportin që do mbajë në drejtim të Qeverisë së Durrësit dhe veprimtarinë diplomatike që do ta mbajë drejt Parisit në kuadrin e memorandumeve dhe protestave për zgjidhjen e problemit shqiptar. Kapitulli i dytë “LËVIZJA KAÇAKE NË KOSOVË (1918-1924)” do të përmbledhet me krijimin e forcave kryengritëse. Do trajtohet Lëvizja Nacionalçlirimtare, e njohur me emrin Lëvizja Kaçake, gjatë viteve 1918-1924, që kishte qëllimin kryesor luftën për çlirimin kombëtar të shqiptarëve të Kosovës nga robëria jugosllave.

Do flitet po ashtu edhe për Zonën Neutrale të Junikut, dhe krejt në fund do trajtohet dhe veprimtaria e Partisë së Xhemijetit. Pjesa e tretë e punimit “VEPRIMTARIA E KOMITETIT TË KOSOVËS NË VITET 1919-1920” do të filloj me pikëpamjet politiko-shoqërore të gazetës “Populli”, që ishte organ i Komitetit të Kosovës, puna kryesore e të cilit ishte problem i zgjidhjes së çështjes kombëtare. Po ashtu do të shtjellohet edhe kontributi që dha Komiteti i Kosovës në formimin e qeverisë së Lushnjës dhe mbrojtjen e vendimeve të miratuara në këtë Kongres. Organizimi i forcave ushtarake në mbrojtje të Koplikut dhe qëndrimi i autoriteteve jugosllave ndaj Komitetit të Kosovës janë pjesë e këtij kapitulli. Dhe në fund, apo në kapitullin e katër që ka të bëjë me veprimtarinë politiko-ekonomike të Komitetit të Kosovës, gjatë viteve 1920-1924, do trajtohen problemet ekonomike që do i ketë Komiteti i Kosovës, që do të shtroheshin detyra të mëdha, aktiviteti i brendshëm dhe i jashtëm, dhënia e ndihmave, mbajtja e gazetave etj. Po ashtu, raporti me qeverinë e Nolit, si dhe në fund do flitet për kundërrevolucionin e Zogut, i cili pasi u kthye në vend, filloi përndjekjen e patriotëve shqiptar, duke arritur të shpërndaj edhe Komitetin e Kosovës në dhjetor të vitit 1924.